

Dhjetor 2023 | Nr. 33



BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË MIKPRITI
ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË RESIJ





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË MIKPRITI ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË RESIJ

Në Tiranë u mbajt për herë të parë Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit European të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), nën kujdesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që

është anëtar i këtij Rrjeti, me pjesëmarrjen e delegacioneve të inspektorateve të Drejtësisë të Rumanisë, e cila ka presidencën e RESIJ, të Francës, Italisë, Belgjikës, Bullgarisë, Spanjës e





Portugalisë. Në fjalën përshëndetëse, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani falenderoi kolegët e vendeve të Bashkimit Evropian, që vendosën pranimin e ILD-së në RESIJ, si anëtar me të drejta të plota.

“Vendimmarrjen tuaj për të anëtarësuar institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë në RESIJ, e shikoj para së gjithash si një vlerësim për angazhimin e deritanishëm të institucionit të ILD të Republikës së Shqipërisë në këtë rrjet. Nga ana tjetër, anëtarësimin e ILD-së në RESIJ e shikoj edhe si

një konfirmim të vullnetit dhe bashkëpunimit tonë të përbashkët.”, tha z. Metani.

Ndërsa duke iu referuar projekteve të ardhshme të RESIJ, me ndryshimet në statutin e kësaj organizate, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vërejtë se “Sot RESIJ “fiton” një personalitet të ri juridik. Personalisht vlerësoj se tashmë RESIJ kërkon një vëmendje të veçantë. Aktualisht qasja jonë ndaj aktiviteteve të tij kërkon një kujdes të shtuar dhe më shumë angazhim. Për çdo organizëm të këtij lloji, zhvillimi dhe rritja e tij përpara, përveçse bashkëpunimit, veprimi





apo energjisë, kërkon mbi të gjitha një mision, i Drejtësisë i Shqipërisë e kupton kontributin e tij kërkon një planifikim në nivel strategjik duke brenda Rrjetit European të Shërbimeve të In- përcaktuar prioritetet të qarta, si dhe një qasje sa spektimit të Drejtësisë.”

me gjithëpërfshirëse nga të gjithë ne për arritjen e qëllimeve të tij.”
Në fjalën e saj, Presidentja e RESIJ, shefja e Inspektimit Gjyqësor të Rumanisë, znj. Roxana Ioana Petcu u shpreh se “E vlerësoj shumë angazhimin e Shqipërisë në veprimtarinë e Rrjetit dhe organizimi i sotëm na dëshmon për mënyrën e patëmetë dhe të përgjegjshme, me të cilën Inspektori i Lartë

anëtarët miratuan ndryshimet finale në Statutin e Rrjetit, si dhe diskutuan mbi projektet e ardhshme të RESIJ, si dhe propozuan dinamizimin e Rrjetit përmes shkëmbimit të inspektorëve, ndarjes së eksperiencës metodologjike të inspektimit dhe angazhimin në sfidat e përbashkëta si pavarësia e

Gjatë Asamblesë së Përgjithshme të RESIJ, anëtarët miratuan ndryshimet finale në Statutin e Rrjetit, si dhe diskutuan mbi projektet e ardhshme të RESIJ, si dhe propozuan dinamizimin e Rrjetit përmes shkëmbimit të inspektorëve, ndarjes së eksperiencës metodologjike të inspektimit dhe angazhimin në sfidat e përbashkëta si pavarësia e





magjistratëve dhe pritshmëria e publikut nga sistemi i drejtësisë.

RESIJ, Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë është krijuar në Paris, në Mars 2017, si një iniciativë e Francës, në prani të përfaqësuesve të Bashkimit Evropian e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë të Këshillit të Evropës (CEPEJ) dhe përfaqësuesve nga Belgjika, Republika Çeke, Franca, Italia, Lituania, Mali

i Zi, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Serbia, Sllovenia, Spanja, Britania e Madhe. Në Dhjetor 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i Shqipërisë (ILD) u pranua me statusin e vendit vëzhgues në gjirin e këtij Rrjeti, që përbëhej nga Belgjika, Bullgaria, Franca, Italia, Spanja, Portugalia dhe Rumania. Prej 19 Tetorit 2023, anëtarët e Rrjetit vendosën të pranonin Inspektorin e Lartë të Drejtësisë së Shqipërisë, si anëtar me të drejta të plota.





FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË RRJETIT EVROPIAN TË SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT (RESIJ)

Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit për prezencën tuaj sot në Tiranë!

Sot nuk mund t'a fsheh ndjesinë që kam dhe lumturinë që ndjej për zhvillimin e këtij aktiviteti. Sot pas gati një viti e gjysëm më vonë, jemi përsëri bashkë. Ndihem shumë i privilegjuar dhe i nderuar, që mbledhja e radhës së Asamblesë së Përgjithshme të RESIJ, po zhvillohet në Shqipëri.

Gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur një bashkëpunim intensiv. Kemi zhvilluar shumë aktivitete në kuadër të RESIJ, por ky takim sot për mua ka një domethënie tjetër. Ndoshta për vetë faktin se institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, tashmë gëzon statusin e anëtarit të RESIJ. Faleminderit të gjithëve ju! Është nder për institucionin të cilin drejtoj, që sot të jetë pjesë e këtij organizmi me cilësinë e anëtarit të tij.

Vendimmarrjen tuaj për të anëtarësuar institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë në RESIJ, e shikoj para së gjithash si një vlerësim për angazhimin e deritanishëm të institucionit të ILD të Republikës së Shqipërisë në këtë Rrjet. Nga ana tjetër, anëtarësimin e ILD-së në RESIJ, e shikoj edhe si një konfirmim të vullnetit dhe bashkëpunimit tonë të përbashkët.

Megjithatë krahas vlerësimit dhe bashkëpunimit, e shikoj edhe si një përgjegjësi të madhe. Këtë proces anëtarësimi e shikoj si një sfidë për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave të Rrjetit dhe kontributit, të cilin duhet të japin tashmë në cilësinë e anëtarit dhe përmbushjes së një sërë detyrimesh, të cilat mund të rrjedhin në të ardhmen.

Në të njëjtën kohë, mbledhja e sotme e Asamblesë së Përgjithshme të RESIJ, ka një



rëndësi tejet të veçantë. Duke mbajtur në konsideratë ndryshimet e sotme, të cilat do të ndërmarrim në Statut, ne synojmë përcaktimin e rregullave të reja mbi organizimin dhe funksionimin e tij. Kjo fazë përkon me një fillim të ri të veprimtarisë së RESIJ.

Sot RESIJ “fiton” një personalitet të ri juridik. Personalisht vlerësoj se tashmë RESIJ kërkon një

vëmendje të veçantë. Aktualisht qasja jonë ndaj aktiviteteve të tij kërkon një kujdes të shtuar dhe më shumë angazhim. Për çdo organizëm të këtij lloji, zhvillimi dhe rritja e tij përpara, përveçse bashkëpunimit, veprimit apo energjisë, kërkon mbi të gjitha një mision, kërkon një planifikim në nivel strategjik duke përcaktuar prioritetet të qarta, si dhe një qasje sa më gjithëpërfshirëse nga të gjithë ne për arritjen e qëllimeve të tij.



Sot RESIJ “fiton” një personalitet të ri juridik. Personalisht vlerësoj se tashmë RESIJ kërkon një vëmendje të veçantë. Aktualisht qasja jonë ndaj aktiviteteve të tij, kërkon një kujdes të shtuar dhe më shumë angazhim.

Gjatë këtyre ditëve, duke menduar mbi konsideratat e mia dhe fjalën time, të cilën do të ndaja me ju, me erdhën në mendje disa dilema apo ndjesi, me baza skepticizmi lidhur me të ardhmen e RESIJ, të cilat i shtrua për diskutim edhe përgjatë konferencës së Qershorit “Tirana 2022”. Janë vështirësitë me të cilat ne përballemi, e që vijnë si pasojë e dallimeve, që ne anëtarët e RESIJ kemi nga pikëpamja politike, juridike, apo organizative dhe institucionale.

Duke bërë një analizë në retrospektivë, të veprimtarisë së deritanishme të RESIJ, arrijë në përfundimin, se të gjithë ne bashkë ia kemi dalë, jo vetëm të tejkalojmë këto barriera, të cilat ngrihen përpara nesh për shkak të këtij *diversiteti*, por edhe të prodhojmë rezultate të qarta, jo vetëm për një periudhë

afatshkurtër, por edhe për vitet në vijim.

Megjithatë kemi akoma më shumë për të bërë. Zhvillimi i këtij takimi sot, si dhe agjenda e tij është një tregues i qartë, që jemi në rrugën e duhur. Për sa kemi vepruar deri më tani, duke aplikuar metodat apo qasjet më të mira të partneritetit dhe komunikimit të suksesshëm, si dhe duke pasur një vullnet të mirë për të kontribuar në zhvillimin e rolit të shërbimeve të inspektimit në përputhje me vlerat tona të përbashkëta evropiane, si demokracia dhe shteti i së drejtës, personalisht mendoj se do të arrijmë që RESIJ të realizojë misionin për të cilin është krijuar.

Duke ju falënderuar edhe një herë për pjesëmarrjen më lejoni që t'ia kaloj fjalën Presi-





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit Dhjetor 2023, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka pritur 24 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 12 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit Dhjetor 2023, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 12 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

TRANSPARENCA DHE PRITJA E QYTETARËVE NË SHIFRA PËR VITIN 2023

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka përmbyllur një vit me sfida, duke qenë me afër qytetarëve me trajtimin e ankesave të tyre, por edhe dhënien e informacionit të kërkuar. Në harkun kohor të një viti Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka asistuar fizikisht me paraqitjen e tyre pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 237 qytetarë nga e gjithë Shqipëria, që kanë pasur pretendime ndaj magjistratëve të ndryshëm. Ata janë asistuar dhe kanë plotësuar formularin e ankesës që është publikuar edhe në faqen e internetit të institucionit www.ild.al.

Përveç pritjes fizike të qytetarëve në ambientet e Zyrës së Inspektorit të lartë të Drejtësisë, ka pasur edhe asistencë përmes telefonatave në numrin +355 4 2217217. 188 qytetarë shqiptarë kanë marrë informacion përgjatë vitit 2023, mbi mënyrën sesi të ankohen, sa kohë zgjat përfundimi i ankesës së tyre, ku, kur dhe si mund të paraqiten dhe se ndaj kujt mund të ankohen.

Për të lehtësuar edhe më shumë procesin e ankimit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që prej momentit të ngritjes së institucionit solli një formë të re, më të thjeshtuar të ankesës, që qytetarët apo institucionet mund të paraqesin për shkelje të dyshuara nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri.

Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve, Inspektori mund të vihet në lëvizje bazuar në ankimin me shkrim të çdo të personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar. Inspektori i Lartë i heton

shkeljet e dyshuara edhe kryesisht, bazuar në të dhëna publike ose të siguruar në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike, mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Në harkun e një viti Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka përmbushur edhe detyrimin ligjor për të drejtën e informimit. Në harkun kohor të një viti kanë marrë përgjigje 202 kërkesa të tilla, nga qytetarë, apo subjekte të tjera. Gjithashtu, duhet theksuar edhe fakti se gjatë vitit 2023 janë regjistruar edhe 350 vendime me shpallje, në zbatim të nenit 162 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”.

SHIFRAT

- ◆ **241 pritje të qytetarëve ;**
- ◆ **188 telefonata nga qytetarët;**
- ◆ **202 kërkesa për informacion;**
- ◆ **350 vendime me shpallje**

ILD në Twitter



Inspektori i Larte i Drejtesise /
@ILD_Albania

Follow

Vendimmarrjen tuaj për të anëtarësuar institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në RESIJ, e shikoj si një vlerësim për angazhimin e deritanishëm të institucionit në këtë Rrjet, por edhe si një konfirmim të vullnetit dhe bashkëpunimit tonë të përbashkët #RESIJ

#ILD

Translate post



7:39 PM · Dec 14, 2023 · 57 Views



Inspektori i Larte i Drejtesise /
@ILD_Albania

Follow

Për herë të parë në Tiranë Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit European të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë nën kujdesin e ILD, me pjesëmarrjen e Rumanisë, që ka presidencën e RESIJ, Francës, Italisë, Belgjikës, Bullgarisë, Spanjës, Portugalisë

[ild.al/sq/2023/12/14/...](http://ild.al/sq/2023/12/14/)

Translate post



8:30 AM · Dec 15, 2023 · 91 Views



Inspektori i Larte i Drejtesise Artur
Metani

@ild_albania · 7 Dhj

"Duhet të kuptojmë përse u krijua reforma në drejtësi dhe ndarja e pushteteve. Në momentin që fillojmë kuptojmë dhe ta pranojmë këtë ndarje pushtetesh me shumë vështirësi, atëherë do i krijojmë vetes një lehtësi të madhe për të ardhmen" #ILD

2 6 Twitter



Inspektori i Larte i Drejtesise Artur
Metani

@ild_albania · 7 Dhj

Shkëmbime interesante me shoqërinë civile, diplomatë e ekspertë ligjorë mbi reformën në drejtësi dhe rolin e #ILD-së në forcimin e shtetit të së drejtës

4 Twitter



Inspektori i Larte i Drejtesise /
@ILD_Albania

Follow

Po ndodh: Roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në forcimin e shtetit të së drejtës. #konferenca #ILD @ReinoutVos @CSDGALBANIA



10:53 AM · Dec 6, 2023 · 249 Views

4 9

DHJETORI NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Dhjetor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **100 ankesa**.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Djetor 2023**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME

64 vendime nga 105 ankesa të shqyrtuara, konkretisht:

⇒ **60 vendime arkivimi pas verifikimit nga praktika të ILD**, nga të cilat:

47 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar

13 vendime arkivimi pas verifikimit

⇒ **4 vendime arkivimi nga praktika të trashëguara (dosje të mbartura nga ish KLD)**

1 vendim arkivimi pas shqyrtimit fillestar

3 vendime arkivimi pas verifikimit

VERIFIKIME

⇒ **16 vendime verifikimi, nga praktikat e ILD-së.**

HETIME DISIPLINORE

⇒ **1 vendim për fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrat gjyqtar.**

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.


* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevoje, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Dhjetor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **11 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total për vitin 2023 ka bërë ka bërë **350 shpallje publike**.





ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË FINALIZOI PLANIN STRATEGJIK DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR PERIUdhËN 2023 -2025

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë diskutoi në dy sesione pune planin strategjik të institucionit për periudhën 2023-2025 si dhe planin e veprimit për të njëjtën periudhë.

Ky është plani i dytë strategjik që nga ngritja e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. “Prioritetet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, tashmë kanë kaluar nga faza emergjente e ngritjes së një institucioni nga fillimi, tek konsolidimi i përvojës dhe i standardeve, duke kthyer vështirësitë e hasura deri tani, në objektiva pune “. – u shpreh Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, duke përgëzuar grupin e punës për përgatitjen e këtij dokumenti, që do orientojë punën e ILD-së për tre vite.

Dokumenti u prezantua nga drejtuesja e grupit

të punës, znj. Eljona Bylykbashi, drejtore e Drejtorisë së Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike, e cila përmendi se plani mbart përvojën e identifikimit të nevojave dhe kombinimin e tyre, sipas një sistemi të planifikimit, koordinimit dhe monitorimit, do të shënojë një hap cilësor në zbatimin e vendosur.

Planin e ri strategjik përmban një situatë të analizës aktuale të institucionit, vizionin, vlerat e objektivat strategjike, burimet financiare si dhe monitorimi e raportimi.

Diskutime e sugjerime u bënë nga njësi e Inspektorëve, ajo e ndihmës inspektorëve, kabinetit, si dhe drejtorive të administratës, ndërsa në sesionin e diskutimeve të planit të veprimit fokusi u vendos tek sfidat e reja të konsolidimit



të përvijës dhe fuqizimin e mëtjshëm të kapaciteteve përmes krijimit të një sistemi të plotë dhe afatgjatë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor; matjes së performancës së magistratëve, gjyqtarë/prokurorë, lidhur me cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë; forcimit të mekanizmave institucionale për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të subjekteve të procedimit disiplinor; zhvillimin e sistemit të teknologjisë së informacionit për menaxhimin e

çështjeve dhe përmirësimin në vijimësi të kësaj infrastrukture; rritjes së kapaciteteve të inspektorëve nëpërmjet praktikave të trajnimit dhe inspektimit me homologët evropianë; kryerjes së inspektimeve të vazhdueshme tematike dhe institucionale të planifikuara, në zbatim të metodologjisë dhe standardeve përkatëse si dhe rritjen e transparencës dhe aksesit të publikut në veprimtarinë e ILD-së.





Në këtë aktivitet pune të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë morën pjesë edhe përfaqësues të misionit mbështetës të BE, “EU for Justice”.

Eksperti ndërkombëtar z. Álvaro García Pérez-Iraola bëri një paraqitje të ndërthurjes së aktiviteteve të projektit “EU for Justice” me

strategjinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025, me qëllim arritjen e objektivave të përbashkët, rritjen dhe konsolidimin e një institucioni efektiv, të pavarur dhe transparent. “Fushat ku projekti ka fokusuar aktivitetet e ardhshme ndikojnë në aspektin rregullator, organizativ, It, komunikim me publikun dhe rritje kapacitetesh.”, informoi eksperti spanjoll.





RESPEKTIMI I NDARJES SË PUSHTETEVE I SJELL EFEKTIVITET REFORMËS NË DREJTËSI

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani Shqipëri, në kuadër të projektit të platformës mori pjesë në konferencën “Reforma në Cluster 1. drejtësi në Shqipëri dhe roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në forcimin e shtetit të së Nën fjalën e tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë drejtës”, organizuar nga Qendra për Studimin e nënvizoi kënaqësinë, për vëmendjen që kanë Demokracisë dhe Qeverisjes, mbështetur nga organizatat e shoqërisë civile mbi punën e ILD-Ambasada e Mbretërisë së Holandës në së.





“Falenderoj Qendrën (Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes), që e ka organizuar këtë takim sot, por edhe Ambasadën e Vendeve të Ulëta, sepse është e treta, ose e katërta herë, që organizata të ndryshme bëjnë veprimtari për punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është një kënaqësi që puna po vlerësohet, ose po analizohet të paktën, po shqyrtohet mbi bazën e analizave profesionale.”, tha z. Metani.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë u ndal në arsyet, që çuan në reformimin e sistemit të drejtësisë dhe arkitekturën e re të institucioneve të drejtësisë, si baza për një mentalitet të ri shoqëror, atë të respektimit të ndarjes së pushteteve, që në këndvështrimin e tij, sot nuk po transmetohet. “Shoqëria, për shkaqe, dhe nuk e gjykojmë dot shoqërinë, sepse për shkak të mungesës së pro-





kurorëve dhe gjyqtarëve, sot qytetarët nuk marrin drejtësi. Kjo është evidente dhe natyrisht jemi në këtë anë të shoqërisë, por nga ana tjetër edhe organet e reja të drejtësisë ILD, KLGJ, KLP po marrin masa aq sa u takon në ligj, që të adresojnë këto çështje.

Por nëse drejtojmë gishtin, pa kuptuar problematikën, pa kuptuar punën e organeve tona, standardet që po mundohemi të ngremë me

shumë vështirësi, të cilat në këndvështrimin tonë, nuk i përgjigjen debatit politik të momentit, por i përgjigjen sfidës së të ardhmes dhe ajo që po mundohemi të ngremë është për 10 vitet që vijnë, për 15 vitet që vijnë, jo për zgjidhje të situatës, sepse ne e zgjidhim situatën sot, por me shumë gjasa do kthehet në një precedent, të cilin do ta vuajmë pas 10 vitesh. Dhe kështu rrotullohemi përsëri në një rreth vicioz. Dhe për këtë arsye duhet të kuptojmë





përse u krijua reforma në drejtësi dhe ndarja e pushteteve. Në momentin që fillojmë kuptojmë dhe ta pranojmë këtë ndarje pushtetesh me shumë vështirësi, atëherë do i krijojmë vetes një lehtësi të madhe për të ardhmen. Janë shumë vështirësi për momentin, por të paktën e kemi rrugën e qartë për të ardhmen, me një vizion të qartë për të ardhmen. Ky është këndvështrimi im për atë që po ndodh sot. Mund të mos biem dakord padyshim, por unë mendoj që 30 vjet e provuam të kundërtën e kësaj që ndodh sot, dhe erdhëm këtu. Atëherë ta provojmë të respektojmë ndarjen e pushteteve.”, u shpreh z. Metani.





Këndvështrime mbi reformën në drejtësi dhe rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndanë Ambasadori i Mbretërisë së Holandës, Reinout Vos, shefja e Sektorit të Drejtësisë, Çështjeve të Brendshme dhe Qeverisjes së Mirë pranë Delegationit të Bashkimit Evropian znj. Lenka Vitkova, koordinatori rajonal për shtetin e së drejtës i Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Serbi dhe Mal të Zi, z. Bart de Bruijn, si dhe drejtori ekzekutiv i Qendrës për Studime të Demokracisë dhe Qeverisjen z. Arjan Dyrmishi.

Gjetjet dhe rekomandimet e studimit mbi punën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga studjuesja znj. Ilvana Dedja, u diskutuan gjatë konferencës me fokus në rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në garantimin e integritetit dhe llogaridhënies së gjyqësorit nga z. Rene van Veen, gjyqtar i Gjykatës së Apelit në Holandë, znj. Isida Koka, këshilltare në kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Dr. Erind Merkuri, pedagog në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, z. Marash Logu, këshilltar ligjor i grupit par-





FJALA E PLOTË DHE KOMENTET E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË ARTUR METANI NË KONFERENCËN “REFORMA NË DREJTËSI NË SHQIPËRI DHE ROLI I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS”

Është kënaqësi padyshim të jem pjesë e këtij paneli, sepse së pari është një organizim që vjen nga një organizatë e shoqërisë civile dhe unë e kam bindje të thellë, që Organizatat e Shoqërisë Civile mund të luajnë një rol akoma edhe më të fortë, për të bërë pikërisht këtë gjë për të cilën jemi mbledhur sot, diskutimin për reformën në drejtësi, pritshmëritë, ecurinë e Reformës në Drejtësi, sfidat, sukseset, ose standardet që po vendosin, ose nuk po vendosin organet e Drejtësisë. Natyrisht të gjitha këto sfida duhet të maten në bazë indikatorësh cilësorë, sasiorë dhe natyrisht analizash profesionale, në mënyrë që shoqëria civile, edhe shoqëria në përgjithësi, media, politika, të jenë të qartë, sesi një aktor i jashtëm e shikon punën e organeve të drejtësisë dhe padyshim falenderoj Qendrën, që e ka organizuar këtë takim sot, por edhe Ambasadën e Vendeve të Ulëta,

sepse është e treta, ose e katërta herë, që organiza ta të ndryshme bëjnë veprimtari për punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është një kënaqësi që puna po vlerësohet, ose po analizohet të paktën, po shqyrtohet mbi bazën e analizave profesionale.

Së dyti, tema është shumë delikate. Arjani tha që ILD është në pozicion më të favorshëm. Unë do thoja që ILD është në pozicion më delikat, jo të favorshëm, për të bërë pikërisht këtë përhapje të kulturës juridike e politike në komunitet, të vendosjes së standardeve të së drejtës në komunitet. Në fakt kjo është punë e të gjithëve ne. Pra reforma në drejtësi u konceptua, si adresim ndaj problemeve të konstatuara të vonesave, moszbardhjeve, korrupsionit, e kështu me radhë dhe u krijua një arkitekturë e re e institucioneve të dala nga reforma në

drejtësi. Por unë mendoj që kjo arkitekturë e re, krijoi një bazë të re, të fortë për një mentalitet të ri shoqëror, atë të respektimit të ndarjes së pushteteve, të cilin me keqardhje e shoh të mos transmetohet as nga organet e drejtësisë dhe aq më tepër nga organizatat e shoqërisë civile, media, apo politika.

Ky është themeli, nga i cili duhet të fillojë diskutimi për ecurinë e reformës në institucionet e drejtësisë mendoj unë, sepse vetëm duke njohur dhe duke respektuar pavarësinë e ndarjes së pushteteve do kuptojmë që standardet për të cilat po flasim, nuk janë standarde për të mbrojtur gjyqtarët, apo prokurorët, por janë standarde për të mbrojtur shoqërinë.

Nëse shoqëria nuk është dakord sot me një vendim gjyqësor, ose nëse një gjyqtar, ose nëse një prokuror sot vihet përpara përgjegjësisë, sepse shoqëria nuk është dakord me vendimin e tij, apo se shoqëria nuk orientohet, apo nuk orientohet tek institucionet që kushtetuta ka parashikuar për shqetësimet ndaj sistemit gjyqësor, apo më keq akoma, në rast se pushtete të tjera

duan të përfitojnë nga fakti që prokurorë dhe gjyqtarë kanë pamundësi ligjore për të mbrojtur vendimet e veta, atëherë na mbetet vetëm të shtojmë problemet e saj. Nëse nuk arrijmë të kuptojmë këtë, atëherë i gjithë diskutimi shkon në nivele të panjohura dhe në drejtim të paditur.

Nga ana tjetër kjo reformë, apo transmetimi i idesë për ndarjen e pushteteve mund të ketë sukses, nëse ne si shoqëri nuk fillojmë të kultivojmë standarde të së drejtës. Puna e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk është statistikë, as shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Është punë standardesh, standarde mbi cilat janë proceduar prokurorët dhe gjyqtarët sot, në mënyrë që trupa e gjyqtarëve dhe e prokurorëve të jenë të qartë për kontrollin që i pret, mos jetë pjesë e befasisë nga puna e organeve që e procedojnë gjyqtarin dhe prokurorin, në mënyrë që mos i japim shkas organeve të procedurës, ta përdorin këtë kontroll për arsye trafiku influencash politike e financiare. Për këtë arsye e kanë shpërndarë pushtetin.

Së dyti, siç e thashë, drejtësia nuk është statistikë është vlerë shoqërore. Nëse ne nuk fillojmë ta





zhvillojmë si shoqëri që në shkollë, në politikë, në familje, atëherë si mund të presim në që gjyqtarë dhe prokurorë të japin drejtësi? Se padyshim në duam drejtësi të pavarur, po a është gati kjo shoqëri të pranojë drejtësi të pavarur? A është kjo politikë gati të pranojë drejtësi të pavarur? A është media gati të pranojë këtë drejtësi të pavarur? Këto janë diskutime që shkojnë në gen të zhvillimit shoqëror. Dhe pa u diskutuar hapur dhe në gen, unë mendoj që diskutimi për ecurinë e institucioneve të drejtësisë është i mangët. Në këtë këndvështrim, e vlerësoj edhe temën sot, sepse në pamje të parë duket e thjeshtë. Unë mendoj që ky është edhe themeli i keqkuptimit që ka sot shoqëria, edhe me organet e drejtësisë, pra, me punën e organeve të drejtësisë.

Shoqëria, për shkak, dhe nuk e gjej gjë dot shoqërinë, sepse për shkak të mungesës së prokurorëve dhe gjyqtarëve, sot qytetarët nuk marrin drejtësi. Kjo është e evidente dhe natyrisht jemi në këtë anë të shoqërisë, por nga ana tjetër edhe organet e reja të drejtësisë ILD, KLGJ, KLP po marrin masa aq sa u takon në ligj, që të adresojnë këto çështje. Por nëse drejtojmë

gishtin, pa kuptuar problematikën, pa kuptuar punën e organeve tona, standardet që po mundohemi të ngremë me shumë vështirësi, të cilat në këndvështrimin tonë, nuk i përgjigjen debatit politik të momentit, por i përgjigjen sfidës së të ardhmes dhe ajo që po mundohemi të ngremë është për 10 vitet që vijnë, për 15 vitet që vijnë, jo për zgjidhje të situatës, sepse ne e zgjidhim situatën sot, por me shumë gjasa do kthehet në një precedent, të cilin do ta vuajmë pas 10 vitesh.

Dhe kështu rrotullohem përsëri në një rreth vicioz. Dhe për këtë arsye duhet të kuptojmë përse u krijua reforma në drejtësi dhe ndarja e pushteteve. Në momentin që fillojmë kuptojmë dhe ta pranojmë këtë ndarje pushtetesh me shumë vështirësi, atëherë do i krijojmë vetes një lehtësi të madhe për të ardhmen. Janë shumë vështirësi për momentin, por të paktën e kemi rrugën e qartë për të ardhmen, me një vizion të qartë për të ardhmen. Ky është këndvështrimi im për atë që po ndodh sot. Mund të mos biem dakord padyshim, por unë mendoj që 30 vjet e provuam të kundërtën e kësaj që ndodh sot, dhe erdhëm këtu. Atëherë ta provojmë të re-

spektojmë ndarjen e pushteteve.

Pyetje: Unë kontrollova faqen e ILD dhe pashë disa të dhëna interesante, nëse mund t'i quaj kështu. Nga përpunimi i të dhënave, apo ankesave, janë 5685 ankesa të administruara e të tjera në proces, një numër i konsiderueshëm. Ju folët për standarde. A mund të na thoni, cilat janë ato standarde që po vendosni ju me punën tuaj?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Standardet janë ato që parashikon ligji, pra të mbrojmë dhe të respektojmë ato që parashikon ligji. Që do të thotë, se procedura që ndjek Inspektori i Lartë i Drejtësisë për verifikim të një anese ndaj një magjistrati, për hetim ndaj një magjistrati për këtë ankesë, më tej procedim disiplinor përpara këshillave duhet të ketë garancitë më të mëdha që parashikon ligji, për kofidencialitetin e këtij gjyqtari a prokurori e të dhënat e tij. Dhe kjo, jo për të mbrojtur gjyqtarin apo prokurorin, por për të mbrojtur garancinë që parashikon Kushtetuta për figurën e gjyqtarit dhe prokurorit dhe garancinë për një proces te rregullt ligjor. Dhe ky është

standardi më i rëndësishëm, që vendos Inspektori i Lartë i Drejtësisë, së bashku me Këshillat. Dhe sot, ajo që mua më gëzon më shumë janë këto standarde, për të cilat ne po flasim dhe që janë të konfirmuara nga Këshillat. Janë standarde të cilat ka ndjekur Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe janë konfirmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe padyshim Këshillat, në rastet e procedimeve disiplinore. Por çfarë krijon kjo? Kjo krijon padyshim garancitë, që gjyqtarët dhe prokurorët janë të bindur, që as Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe as Këshillat nuk po përdoren politikisht, apo për trafik influencash për t'i proceduar ata në kundërshtim me ligjin. Dhe kjo jep pavarësi dhe duke dhënë pavarësi jep besim! Dhe padyshim që gjyqtarët dhe prokurorët janë të pavarur, edhe pse nuk mund të jesh i pavarur për një ditë. Do kohë. Dhe me këtë pavarësi, mund të ketë edhe raste gjyqtarësh dhe prokurorësh, që abuzojnë me diskrecionin e vendimmarrjes së tyre. Prandaj për të gjitha këto, unë them se duhet kultivuar e drejta si shoqëri, prandaj duhet të organizohemi dhe është përpjekje e të gjithëve ne, jo vetëm e ILD-së dhe Këshillave, por edhe e medias, e shoqërisë civile, e





shoqërisë në përgjithësi, që të shkojmë tek sensi i së drejtës. Dhe këta gjyqtarë e prokurorë në këtë shoqëri kanë ndeshur me këto përparësi, me këto zhvillime dhe me këto mangësi. Siç ka prokurorë dhe gjyqtarë të mirë, ka edhe gjyqtarë dhe prokurorë me probleme. Siç ka dhe mjekë të mirë dhe me probleme; siç ka gazetarë të mirë, ka edhe me probleme; siç ka politikanë të mirë, e të tjerë me probleme. Po nuk kaluam në shina të vizionit të së ardhmes, siç është ndarja e pushteteve dhe respekti për pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke e konsideruar, jo mbrojtje për gjyqtarët dhe prokurorët, por mbrojtje të shoqërisë dhe padyshim që kjo pavarësi që po them, edhe njëherë dua ta theksoj, mund të krijojë një farë kosto për momentin dhe është e natyrshme, por është më mirë të durojmë këtë kosto tani, sesa ta dënojmë një gjyqtar, apo prokuror për shkak të bindjes së tij të brendshme, që mund të mos jetë profesionale, sepse ai atë zhvillim profesional ka. Është më mirë kjo në këndvështrimin tim, sesa të bëjmë një shkelje kushtetuese ligjore, vetëm për të rregulluar një situatë sot.

Pyetje: Nëse një qytetar bën një ankesë sot në ILD, sa kohë duhet që të shqyrtohet kjo ankesë?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Ligji parashikon që Inspektori i Lartë i Drejtësisë për çdo ankesë që paraqitet, ka tre muaj kohë t'i kthejë një përgjigje qytetarit për ankesën që bën, nëse do kalohet për verifikim, apo do arkivohet ankesa që ka paraqitur qytetari. Ky afat përgjithësisht nuk zbatohet për shkak të ngarkesës që ka sjellë backlog-u i trashëguar nga institucionet e mëparshme të Drejtësisë, që kishin për detyrë të trajtonin ankesat e qytetarëve dhe nuk i kishin trajtuar. E gjithë kjo prapambetje e ankesave të patrajtuara erdhi tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Erdhën mbi 2100 ankesa nga institucionet e mëparshme, ndërkohë që për një vit e gjysmë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka punuar me dy veta. Padyshim që dukej jashtë logjikës kryerja e inspektimeve tematike dhe e procedimeve disiplinore, por këto të fundit ne i kemi nisur menjëherë. Dhe mjafton të shikohet sa kohë iu desh ILD-së për të paraqitur procedimin e parë disiplinor dhe sa iu desh një institucioni tjetër p.sh si KPK, që të niste procesin e parë të rivlerësimit, që nga momenti kur nisi punë? Të dhënat janë aty, të qarta. Prandaj them, që kur vjen puna për të matur punën e organeve të drejtësisë, duhet matur me analizë dhe standard, jo me perceptim të përgjithshëm.

Mafton të shikohet sa kohë iu desh ILD-së për të paraqitur procedimin e parë disiplinor dhe sa iu desh një institucioni tjetër p.sh si KPK, që të niste procesin e parë të rivlerësimit, që nga momenti kur nisi punë? Të dhënat janë aty, të qarta. Prandaj them, që kur vjen puna për të matur punën e organeve të drejtësisë, duhet matur me analizë dhe standard, jo me perceptim të përgjithshëm.

Pyetje: A ka një procedurë specifike për pensionistët, apo për njerëzit me aftësi të kufizuara?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Nuk ka një procedurë të veçantë për kategori të veçanta. Inspektori i Lartë i Drejtësisë për shkak se kishte këtë backlog e prapambetur, për shkak se ndërkohë vinin dhe ankesa të reja, ka miratuar një metodologji trajtimi të ankesave, që është publike, ku thuhet se cilat janë prioritetet; që janë afatet e parashkrimit, magjistratët në sistem, të gjitha këto që të bëjnë të mundur, që të përzgjedhësh ankesa dhe të jetë transparent si proces përzgjedhja e ankesës.

Pyetje: Nëse shkelja është flagrante për qytetarin në një proces në shkallën e parë, a i ndiqni ju këto raste?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Ligji parashikon që vendimmarrja e ILD-së është përfundimtare, në kuptimin që e arkivon dhe nëse e arkivon, qytetari ka të drejtë ta ankimojë këtë vendim të ILD-së, ose në Këshillin e Lartë të Prokurorisë për prokuror, ose në Këshillin e Lartë Gjyqësor për gjyqtar. Dhe nëse Këshillat vendosin që Inspektori duhet ta hetojë, e kthen mbrapsht. Në gjithë këtë mori ankesash, që kanë shkuar tek Këshillat për vendimmarrjet e ILD-së, nuk ka asnjë rast, që Këshillat të jenë shprehur me vendimmarrje të kundërt, pra kundër asaj vendimmarrjeje që ka bërë ILD-ja. Nëse kërkesa arkivohet, sepse çështja është në gjykim në shkallë të parë, atëherë këtu përfundon. Qytetari nëse është dakord me vendimin e

Gjykatës së Apelit, apo të Gjykatës së Lartë, atëherë ka përsëri të drejtë të paraqesë ankesë. Por këtu ka një problem, sepse qytetarët që bëjnë një ankesë mendojnë se do të marrin zgjidhjen e çështjes gjyqësore tek ILD, kur nuk është aspak kështu. Dhe ajo që po ndodh, por nuk di çfarë të bëjmë, është se qytetarët, pasi paraqesin ankesë, marrin një letër me numër protokolli nga ILD, pra regjistrimin e ankesës, dhe me këtë shkojnë në çdo proces gjyqësor civil edhe penal dhe thotë unë kam bërë ankesë dhe kërkoj përjashtimin e magjistratëve. Ndërkohë, ky nuk është efekt ligjor, pra bëjnë presion dhe ky është roli delikat, sepse duhet të ruash balanca shumë të rëndësishme. Është shumë e rëndësishme që gjyqtarët, përmes letrave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të mos ndikohen nga as më i vogli presion. Dhe prandaj është delikat roli e pozicioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe jo i favorshëm.

Ndërhyrja përmbyllëse e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Artur Metani:

Unë do doja që nga kjo tryezë diskutimesh, të biem të gjithë dakord me mendimin, që e para njëherë, duhet ndarja e pushteteve dhe pavarësia e institucioneve. Duhet të dalim me idenë që Parlamenti të më kërkojë mua informacion, edhe llogari le të themi, se cila është performanca e ILD-së, duhet të biem dakord, që ILD-ja dhe të gjitha institucionet e pavarura, kanë të drejtë t'i kërkojnë Kuvendit cilësi ndryshe të ligjeve, cilësi ndryshe të debatit ligjor, apo politik që ka, cilësi ndryshe të

Inspektori i Lartë i Drejtësisë për shkak se kishte këtë backlog e prapambetur, për shkak se ndërkohë vinin dhe ankesa të reja, ka miratuar një metodologji trajtimi të ankesave, që është publike, ku thuhet se cilat janë prioritetet; që janë afatet e parashkrimit, magjistratët në sistem, të gjitha këto që të bëjnë të mundur, që të përzgjedhësh ankesa dhe të jetë transparent si proces përzgjedhja e ankesës.

vendimmarrjeve që ata kanë, sepse gjërat janë të lidhura. Nuk mund të ketë sukses një institucion, kushdo qoftë ai, nëse të tjerët kanë ato performanca që kanë. Kjo është ajo që duhet të dalë nga ky takim them unë.

E dyta, duhet të dalim me një mendim të përbashkët prapë, që nuk mund ta pranojmë që Kuvendi në debatet e veta parlamentare, i bën thirrje Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të hetojë këtë, apo atë. Jo pra jo! Kushtetuta e ka parashikuar në sistem, që në qoftë se ke ankesë, çoje ankesën në institucion. Ne nisim verifikim kryesisht padyshim, por kjo është ajo që, nëse nuk bie dakord, pra nëse e nis duhet

ruajtur balanca, se përse e nis që gjyqtari mos e kuptojë, ose të mos e ndjejë, që ti po e bën për arsye politike këtë gjë. Ka ndodhur që është bërë kryesisht dhe gjyqtari është mbrojtur me faktin se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është vënë në lëvizje nga politika, garanci që ta ruan shumë Strasburgu. Çfarë kushton ankesa e bërë? Unë jam skandalizuar nga një debat parlamentar nga maxhoranca dhe opozita, mbi një grua shtatzënë që u arrestua në Shkodër. "I bëjmë thirrje ILD-së ta lirojë nga burgu", - dëgjoja të thuhej. Unë nuk e besoja dot që shpreheshin ashtu. Jo pra jo, duhet të biem të gjithë dakord, që kjo nuk mund të ndodhë, as për debat politik.



KLJ PRANON PROPOZIMIN E ILD PËR MBYLLJE TË PROCEDIMIT DISIPLINOR PËR MAGJISTRATIN M.K.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbyllur procedimin disiplinor për magistratin M.K., gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, bazuar në kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që pasi u njoh me dosjen e procedimit disiplinor, të nisur ndaj magistratit në vitin 2012, konstatoi se shkeljet e pretenduara kanë ndodhur në vitin 2009 dhe në vitin 2012 janë parashkruar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka administruar dosjen e procedimit disiplinor ndaj M.K., gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, i përcjellë pranë ILD-së për kompetencë, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 30.06.2023, si proces i nisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë, bazuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë datë 17.07.2012, bazuar në ankesën e një subjekti bankar. Nga analiza dokumentare e dosjes për identifikimin e elementeve juridike, si dhe fakteve apo rrethanave, ka rezultuar se Ministri i Drejtësisë pas zhvillimit të procesit hetimor ka kërkuar nisjen e procedimit disiplinor dhe i ka propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë të vendosë masën disiplinore “Shkarkim nga detyra”. Pas paraqitjes së kërkesave për nisjen e procedimit disiplinor më ish KLD, Ministri i Drejtësisë ka kërkuar pezullimin e kërkesave për procedim disiplinor ndaj magistratit M.K. Nga ana e tij, Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimet e dt. 14.02.2013 dhe 19.07.2013 në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka vendosur pezullimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit.

Pas kërkesës së ILD-së për rishikimin e pezullimit disiplinor të ish KLD-së si gjëndje juridike, që pengon palët të vazhdojnë më tej procedimin disiplinor të filluar, më dt. 30.11.2023, KLJ vendosi shfuqizimin e vendimeve të ish KLD-së “Për pezullimin e procedimit disiplinor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykata më të

larta” dhe vijimin e shqyrtimit të kërkesës për procedimin disiplinor ndaj magistratit M.K. dhe dërgimin e akteve Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Nga praktika dokumentare lidhur me kërkesën për procedimin disiplinor nga ana e Ministrit të Drejtësisë në lidhje me magistratin M.K. rezulton se shkeljet e pretenduara kanë ndodhur në vitin 2009 dhe në vitin 2012 dhe janë parashkruar. Instituti i parashkrimit shuan të drejtën e organit disiplinor të hetojë dhe të japë vendim për masë disiplinore ndaj magistratit për shkak të kalimit të një kohe të gjatë nga koha e kryerjes së shkeljes disiplinore, i cili llogaritet nga momenti i kryerjes së shkeljes disiplinore të pretenduar. Në këndvështrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, respektimi i afatit të parashikuar për kryerjen e procedimeve disiplinore është në funksion të garantimit të parimit të sigurisë juridike dhe kërkoi nga KLJ në seancën e sotme mbylljen e procedimit disiplinor, të filluar ndaj magistratit M.K. për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore për të cilat ka nisur ky procedim, kërkesë që u pranua nga anëtarët e KLJ-së.





ILD JU URON GËZUAR VITIN E RI 2024!



DHJETOR 2023

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD

**KONTAKT ILD**

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
 Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
 Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*Kliko për të ndjekur spotin
 prezantues të ILD*



Më skano!